

EQSC

European Quality & Safety Control



Cilësia nuk është e KUSHTUESHME, është e PAÇMUESHME.

AUDITIM
CERTIFIKIM
TRAINIM
EKSELENCË

ISO Management-Systems

Pse t'a lini certifikimin tuaj në dorë të fatit?

Nëse ju jeni i zënë duke drejtuar biznesin tuaj, të gjesh njerëzit dhe organizatat e duhura për të siguruar certifikimin tuaj, mund të jetë e lodhshme dhe e mbushur me panjohura.

Pra, pse t'ia lini diçka kaq të rëndësishme në dorë të fatit? Nëse ju jeni përgjegjës për të garantuar se biznesi juaj është i certifikuar, sigurohuni që organizmi certifikues që do të zgjidhni është EQSC.

EQSC si një Trupë kontrolli e akredituar, kombinon njohuritë teknike dhe ekspertizën me paanshmërinë dhe kërkesën për t'i shërbyer interesit publik së pari. Certifikimi nga EQSC ofron sigurinë në treg se klientët e certifikuar nga EQSC ushtrojnë aktivitetin e tyre bazuar në standardet për të cilat janë certifikuar.

Procesi i certifikimit në **EQSC** ju ofron konsumatorëve besimin se cilësia e shërbimit të siguruar është i një standardi të lartë dhe në vazhdimësi ruhet po i njëjti nivel cilësie.

ISO-9001
ISO-14001
ISO-39001

ISO-27001
Integrated-Management-Systems

ISO-22000
ISO-17025
ISO-20000
OHSAS-18001

Shërbimet

Si një pjesëmarrës aktiv në tregu EQSC ofron shërbime të përshtatura sipas nevojave të klientit. Përfaqsjë jonë e orientuar drejt klientit vërtetohet nga auditorët, trajnuesit dhe vlerësuesit tanë mjaft profesionistë dhe të kualifikuar.

Një burim, çdo shërbim - **EQSC** ofron një spektër të gjerë shërbimesh për sektorë të ndryshëm:

- > Cilësi
- > Sisteme të Integruara Menaxhimit
- > Mjedis
- > Shëndeti dhe Siguria në Punë
- > Siguria e Informacionit

- > Siguria Ushqimore
- > Menaxhimi i Shërbimeve ITT
- > Laboratorë
- > Siguria në Rrugë
- > Ekselencia

Certification

Interesim për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit

Klienti shpreh interesim për certifikimin e sistemit të tij të menaxhimit.

Aplikim pranë EQSC

Kontaktohet EQSC dhe pajiset me paketën e aplikimit (ose shkarko nga ëë.eqsc-cert.com)

Formulari i aplikimit plotësohet dhe nënshkruhet. Formulari i aplikimit së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse, dorëzohet pranë EQSC.

Vlerësimi i aplikimit

Personi përkatës në EQSC vlerëson nëse Formulari i aplikimit dhe dokumentet përkatëse janë të sakta.

Nëse jo të sakta, klienti duhet të sigurojë informacion/dokumente sipas kërkesave të EQSC.

EQSC i paraqet klientit një ofertë financiare për të gjithë ciklin e certifikimit prej tre vitesh.

Certifikimi fillestar

Faza 1 e Auditimit

EQSC informon klientët rreth organizimit të Fazës 1 & 2 të Auditimit.

Klienti paguan ofertën përkatëse financiare.

Krye-auditori dhe ekipi i auditimit i EQSC zhvillojnë Fazën 1 të Auditimit, për verifikimin e sistemit të menaxhimit.

Certifikimi fillestar

Faza 2 e Auditimit

Krye-auditori dhe ekipi i auditimit të EQSC zhvillojnë Fazën 2 të Auditimit në terren të klienti dhe finalizojnë Raportin e Auditimit.

Klienti zgjidh të gjitha jo-konformitetet e gjetura brenda afateve të përcaktuara nga ekipi i auditimit.

Certifikimi fillestar

Vendimi i Certifikimit/Certifikata

Certifikuesit e EQSC vlerësojnë Raportin e Auditimit dhe jo-konformitetet përkatëse, masat korrigjuese, etj., dhe marrin vendimin final të certifikimit.

Nëse vendimi është pozitiv, klienti pajiset me Certifikatën e konformitetit.

Viti i parë dhe i dytë i Certifikimit

Klienti përmbyll pagesën e ofertës financiare finale për çdo vit.

Krye-auditori dhe ekipi i auditimit i EQSC zhvillojnë Auditimet në terren të klienti dhe finalizojnë Raportet e Auditimit, për çdo vit.

Pas çdo auditimit certifikuesit e EQSC merr vendimin përkatës të certifikimit dhe konfirmon vlefshmërinë e certifikatës së lëshuar gjatë Certifikimit fillestar.

Viti i tretë i Certifikimit

Auditimi i ri-certifikimit

EQSC pajis klientin me një ofertë të re financiare për tre vitet e ardhshme.

Klienti paguan ofertën financiare përpara auditimit në terren.

Krye-auditori dhe ekipi i auditimit i EQSC zhvillojnë Auditimet në terren të klienti dhe finalizojnë Raportet e Auditimit, nëpërmjet vlerësimit edhe të ciklit trevjeçar të certifikimit.


Pas auditimit certifikuesi i EQSC merr vendimin e certifikimit përkatës dhe lëshon certifikatën e re.

Parimet dhe Politikat e EQSC

Politika e Cilësisë së EQSC-it është fokusuar në sigurimin e besueshmërisë së vendimeve të certifikimit, të cilat duhet të jenë në përputhje të plotë me parimet EQSC-së.

EQSC është i paanshëm, kompetent, i përgjegjshëm, transparent, siguron konfidencialitet dhe zgjidhjen e ankesave të cilat kanë të bëjnë me vendimet e certifikimit.

Politika e Cilësisë së EQSC-së është bazuar në parimet e EQSC-së dhe ka Objektiva të përcaktuar si dhe Metoda për arritjen e tyre.



Përse duhet të bashkëpunoni me një kompani të certifikuar nga EQSC?

Duke përzgjedhur një klient të certifikuar nga EQSC, mund të jeni të sigurtë se po merrni shërbimin më të përshtatshëm për nevojat tuaja.

Ka një mori arsyes pse ju duhet të përdorni shërbimet e klientëve të certifikuar nga EQSC:

- › Minimizimin e rrezikut të përzgjedhjes së ofruesit të duhur të një produkti/shërbimi duke ju dhënë besimin që ju do të merrni shërbimin/produktin që plotëson më mirë kërkesat tuaja;
- › Përfitim të marrëdhënieve të reja të biznesit, pasi përdorimi i shërbimeve të certifikuara është gjithnjë e më tepër një kriter i kërkuar, më së shumti në sektorin publik;
- › Ju ndihmon për të identifikuar praktikën më të mira, duke qenë se ofruesi juaj i shërbimit /produktit duhet që të ketë njohuritë e duhura mbi sektori ku ushtron aktivitetin e tij;
- › Ofron diferencimin e tregut dhe udhëheqje duke ju treguar të tjerëve prova të besueshme të praktikave të mira (certifikimin);
- › Vërteton se është kryer kontrolli i duhur në rast të veprimeve juridike;
- › Zvogëlon punën me dokumentacionin dhe rrit efikasitetin duke zvogëluar nevojën për të rikontrolluar biznesin /aktivitetin tuaj, nga palët e treta.

Akredituar si Trupë
Certifikimi në përputhje me
S SH ISO 17021:2011,
nga Drejtoria e Përgjithshme
e Akreditimit.



CS 004 24.11.14

European Quality & Safety Control

Rr. Hamid Shijaku, 6/3

1000 Tiranë, Shqipëri

Tel : +355 4 222 7674

E-Mail : info@eqsc-cert.com

Web : www.eqsc-cert.com